



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 83/ 2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Lazić kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) nr 1127-2014 të datës 27.05.2014 lidhur me emërimin e kryesuesve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në komunën e Mamushës, në seancën e panelit të mbajtur me 30.05.2014, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si i palejuar apeli i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP)

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel nga subjekti politik KTAP paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me nr 1127-2014 të datës 27.05.2014, lidhur me emërimin e anëtarëve dhe kryesuesve të KVV-ve në komunën e Mamushës, ku sipas parashtruesit të ankesës për kryesues të KVV-ve janë emëruar vetëm anëtarët nga subjekti politik KDTP e jo edhe nga subjektet e tjera politike. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 77.3 të LZP-së e ku thuhet se kryesuesit e KVV-ve emërohen përfaqësuesit e katër partive më të mëdha të dala në zgjedhjet e fundit parlamentare e që sipas rezultateve të zgjedhjeve të mbajtura në vitin 2010 partitë me më së shumti vota në komunën e Mamushës janë PDK, LDK, AKR dhe KDTP.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 78/2014 të datës 29.05.2014, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në apel.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ,si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 83/2014 më datën 30.05.2014.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i,